

STATUTI I SHOQERISE ANONIME "BERALB" SH.A.



Ne baze te aktit te themelimit si dhe ne zbatim te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" veprintaria e shoqerise "BERALB" SH.A. do te organizohet et dhe drejtohet sipas ketij Statuti.

Shoqeria anonime "BERALB" SH.A. krijohet nga aksioneret :

1. BER-ONER MADENCILIK VE TICARET A.S. Buyukdere Cad. Noramin Is Merkezi No: 55, Kat: 3, D:304 80670 - MASLAK - ISTANBUL - TURQI, regjistruar me Nr. 237240-184807 date 13 Janar 1993, si kompani minerare, e perfaqesuar nga HASAN BERKPINAR, lindur ne Akcadag-Turqi, me 01 mars 1941, banues ne GAZIMUHTARPASA SOKAK NO: 14/9 KADIKOY - ISTANBUL - TURQI, me Nr.Pass. TR-L-187020.
2. AYHAN ÇETINER, lindur ne Iskenderun - Turqi me 02 shtator 1938, me vend banim ne VAPUR YOLU NO: D-8, 81070 - SUADIYE - ISTANBUL - TURQI, me Nr.Pass. TR-L-032645.
3. MOİZ BERKMAN, lindur ne Istanbul - Turqi me 03 qershor 1955, me vend banim ne PEMBEGÜL SOKAK NO: 10, D-6, 81070 - SUADIYE - ISTANBUL - TURQI me Nr. Pass. TR-H 329547.
4. BERTAN H. BERKPINAR, lindur ne Akcadag - Turqi me 10 nentor 1966, me vend banim ne GAZIMUHTARPASA SOKAK NO: 14/9 KADIKOY - ISTANBUL - TURQI, me Nr. Pass. TR-K-270916.
5. SHAHIN ÇELIK, lindur ne Kırcaali - Bullgari me 26 Shtator 1958, me vend banimi ne Vişnelik Mh. Çolpan Sk. No:21/15 Eskişehir-Turqi, me Nr. Pass. TR-H-250890.

NENI 1

Forma e shoqerise

Shoqeria do te jete anonime, pa oferte publike, persa kohe qe Asambleja e shoqerise nuk do te marre nje vendim per shndrimin e saj ne shoqeri anonime me oferte publike apo ne nje forme tjeter.

Veprintaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit 7638 "Per shoqerite tregtare", nga ky statut dhe legjislacioni ne fuqi.

Shoqeria eshte person juridik dhe e ushtron aktivitetin e saj ne gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

Kjo shoqeri e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin tregetar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

NENI 2

Emertimi

Emertimi i plote i shoqerise eshte: "BER-ONER-ALBANIA-MINERAR" S.H.A.

Emertimi i shkurtuar eshte: "BERALB" S.H.A.

Ne te gjitha aktet ose dokumentat e shpallura nga shoqeria , te destinuar per te tretet , shenohet emri i plote i shoqerise ose i shkurtuar, vlera e kapitalit themeltar dhe emrat e anetareve te drejtorise dhe e Kryetrit te Keshillit Mbikqyres .

NENI 3

Selia

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Ded Gjon Luli, Pallati 1, Shk. 2, Apat. 33 Tirane, Republika e Shqiperise.

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter me vendim te Asamblese se aksionereve.

Mund te transferohet edhe me vendim te Keshillit Mbikqyres por duhet te ratifikohet nga Asambleja e aksionereve ne mbledhjen me te pare.

Neni 4

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte 40 (dyzet) vjet. Ajo e pushon veprimtarine e saj ne vendim te mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese se aksionereve, ose sipas dispoziatve ligjore ne fuqi.

NENI 5

Objekti i shoqerise

Objekti i shoqerise eshte: Te zhvilloje, konstruktoje dhe modernizojte industrine minerare ne Shqiperi, te kryej studime gjeologjike e minerare, te zhvilloje ne pergjithesi aktivitet importues e eksportues.

Shoqeria , brenda hapsirave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregetar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthore me objektin e saj.

Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e sipermarryeve te reja dhe pjesemarrjen ne sipermarrye te tjera si brenda edhe jashte vendit pa cenuar objektin e shoqerise.

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 30 000 (Tridhjet mij) USD, e barabarte kjo ne kohen e derdhjes ne banke te kapitalit me 4'245'500 (Kater milion e dyqind e dyzet e pese mije e peseqind) leke, i ndare ne 300 (treqind) aksione, me vlere nominale per ç'do aksion 100 (nje qind) USD, e barabarte kjo ne kohen e derdhjes se kapitalit ne banke me 14 151,6667 leke (katermbedhjet mije e njeqind e pesedhjt e nje leke e 66.67 qindarka) per çdo aksion.

Ky kapital zoterohet perkatesisht nga :

1. BER-ONER MADENCILIK SANAYI VE TICARET A.S., e perfaqesuar nga HASAN BERKPINAR, ka derdhur 28 800 (njezet e tete mije e teteqind) USD, e

- barabarte kjo ne kohën e derdhjes ne banke te kapitalit me 4 075 680 (kater milion e shtatedhjet e pese mij e gjashteqid e tetedhjet e leke. Zoteron 288 (dyqind e tetedhjet e tete) aksione ose 96% (nentedhjet e gjashte perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. AYHAN ÇETINER, ka derdhur 300 (treqind) USD, e barabarte kjo ne kohën e derdhjes ne banke te kapitali me 42 455 (dyzetedy mij e katerqind e pesedhjet e pese) leke. Zoteron 3 (tre) aksione ose 1% (nje perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.
3. BERTAN H. BERKPINAR, ka derdhur 300 (treqind) USD, e barabarte kjo ne kohën e derdhjes ne banke te kapitali me 42 455 (dyzetedy mij e katerqind e pesedhjet e pese) leke. Zoteron 3 (tre) aksione ose 1% (nje perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.
4. MOİZ BERKMAN, ka derdhur 300 (treqind) USD, e barabarte kjo ne kohën e derdhjes ne banke te kapitali me 42 455 (dyzetedy mij e katerqind e pesedhjet e pese) leke. Zoteron 3 (tre) aksione ose 1% (nje perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.
5. SHAHIN ÇELIK, ka derdhur 300 (treqind) USD, e barabarte kjo ne kohën e derdhjes ne banke te kapitali me 42 455 (dyzetedy mij e katerqind e pesedhjet e pese) leke. Zoteron 3 (tre) aksione ose 1% (nje perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 7

Ndryshimet e kapitalit themeltar

I vetmi organ kompetent per ndryshimin e kapitalit eshte mbledhja e jashtezakonshme e aksionereve e cila merr vendim ne baze te raportit te Drejtorise qe permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Kapitali themeltar mund te zmadhoher me te gjitha menytrat dhe modalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim.

Asambleja e aksionareve eshte i vetmi organ qe vendos te rrise ose te ule kapitalin e shoqerise dhe aksionaret kane te drejte te marrin pjese ose ti permbahen kesaj pjesemarrje ne proporcion me numurin e aksioneve ne pronesi te tyre.

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar do te kryhet konform dispozitave te Seksionit VI te kreut te V me titull "Ndryshimi i kapitalit themeltar" te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

NENI 8

Aksioneret, te drejtat dhe detyrat e tyre

Aksioneret e shoqerise jane persona fizike ose juridike, qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksione te shoqerise me te gjitha menytrat e parashikuara ne ligj dhe nga ky Statut. Zoterimi i aksioneve u jep te drejten atyre te marrin pjese ne Mbledhjet e Asamblese. Votat qe zoterojne aksioneret jane propocionalisht me perqindjen e aksioneve qe zoterojne.

Cdo aksioner ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndarshme te shoqerise, ne perputhje me aksionet e tij, sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e aksionereve ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe nga ky statut.

Aksioneret jane vet pergjegjes per detyrimet dhe per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne.

Neni 9

Format e aksioneve dhe libri i aksioneve

Aksionet jane nominale.

Pronesia e aksioneve pasqyrohet ne librin e aksioneve, te mbajtura nga ana e shoqerise.

Libri i aksioneve duhet te permbaje per cdo aksioner : numurin dhe kategorine e aksioneve, daten e marrjes nga aksioneri, emrin, mbiemrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vleren nominale per cdo aksion te zoteruar.

Seicili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga Libri i aksioneve, i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Seicili aksioner ka te drejte te verifikoi ne se emri i tij eshte regjistruar ne librin e aksioneve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar ti tregoje aksionerit me kerkesen e ketij te fundit, pasqyrimin perkates ne liber.

NENI 10

Trasferimi i pronesise se aksioneve

Aksjonet e shoqerise jane lirisht te transferueshem.

NENI 11

Organet e shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Asambleja e aksionerve
2. Keshilli Mbikqyres
3. Drejtoria

NENI 12

Asambleja e aksionereve

Asambleja eshte organi me i larte i shoqerise.

A. Asambleja e zakonshme

Asambleja e zakonshme merr te gjitha vendimet e percaktuara ne ligj ose nga ky statut, me perjashtim te rasteve kur vendimet perfshihen ne kompetencen e Asamblese se jashtezakonshme.

Asambleja e zakonshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Ky afat mund te zgjatet me vendim gjyqsor. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem ne qoftese aksioneret e pranishem ose te perfaqrsuar zoterojne te pakten nje te katerten e aksioneve me te

drejte vote. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet , ne te dyten nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendime me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Asambleja e zakonshme pergjithesisht ka keto kopetenca:

1. Miraton plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
2. Miraton, ndryshon ose hedh poshte llogarite vjetore qe i shtrohen per miratim.
3. Vendos per shperndarjen e fitimit vjetor.
4. Emeron dhe shkarkon anetaret e Keshillit Mbikqyres.
5. Emeron ekspertin kontabel te autorizuar.
6. U cakton anetareve te Keshillit Mbikqyres si shperblim nje shume vjetore fikse per pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e ketij keshilli.

B. Asambleja e jashtezakonshme

Asambleja e jashtezakonshme e zhvillon mbledhjen e saj ne se aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten 50% te aksioneve me te drejte vote. Ne qoftese perfaqesimi eshte me pak se 50% thirret nje mbledhje e dyte. Mbledhja e dyte zhvillon punimet kur aksioneret qe jane te pranishem ose te perfaqesuar zoterojne 25% te aksioneve me te drejte vote. Ne mungese te ketij quorumi, mbledhja e dyte e Asamblese mund te shtyhet per nje date tjeter , jo me larg se dy muaj nga data e thirrjes se pare. Asambleja merr vendime me shumice votash prej tre te katertat qe u perkasin aksionerve te pranishem apo te perfaqesuar.

Asambleja e jashtezakonshme ka te drejte:

1. Te ndryshoje Statutin.
2. Te ndryshoje (zmadhoje ose zvogeloje) kapitalin e shoqerise.
3. Shndrimin e shoqerise ne nje forme tjeter.
4. Miraton prishjen e shoqerise

Neni 13

Thirrja e mbledhjes se asamblese


Asamblene e aksionereve e therrasin:

1. Keshilli Mbikqyres.
2. Drejtori.

Ne mungese te Drejtorit ose kur nuk mblidhet shumica e Keshillit Mbikqyres.

Asamblene mund ta therrasin: Eksperti kontabel i autorizuar, likujduesit ose nje mandatabajtes i caktuar nga gjykata, me kerkese te cdo personi te interesuar per nje rast urgjent, ose te nje apo disa aksionereve qe zoterojne se bashku te pakten 10 perqind te kapitalit themeltar.

Mbledhja e Asamblese thirret nepermjet lajmerimit qe botohet ne nje gazete te autorizuar per publikimin e njoftimeve ligjore. Ne rast se te gjitha aksionet jane nominative apo ne rast se shoqeria ka nje aksioner te vetem, njoftimi behet me leter rekomande ne adresen e cdo aksioneri me shpenzimet e shoqerise. Njoftimi duhet te



bjere ne dore te aksionerit apo te njhet prej tyre, te pakten 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese. Ne njoftim percaktohet: dita, data dhe vendi ku behet mbledhja si dhe rendi i dites.

Rendi i dites i mbledhjeve te Asamblese percaktohet nga autori i lajmerimit. Nje apo disa aksionereve qe perfaqesojne te pakten 5 perqint te kapitalit, u njihet e drejta per te futur ne rendin e dites disa projekt rezoluta. Projekt rezoluta dergohet ne seline e shoqerise se bashku me dokumentin ku vertetohet zoterimi apo perfaqesimi i te pakten 5 perqint te kapitalit.

Asambleja nuk mund te shqyrtoje nje ceshtje qe nuk percaktohet ne rendin e dites.

Rendi i dites i Asamblese nuk mund te ndryshohet ne lajmerimin e dyte.

Cdo aksioner perfaqeson nje vote. Cdo aksioner mund te perfaqesohet nga nje aksioner tjetër i shoqerise ose nga bashkeshorti (burri ose gruaja). E drejta e votes mund te ushtrohet me ane te nje prokure. Mandati jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese. Ai mund te jepet edhe per dy mbledhje nga te cilat nje e zakonshme dhe tjetra e jashtezakonshme.

Neni 14

Drejtimi i mbledhjes

Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij Asambleja zgjedh drejtues te mbledhjes se saj.

Drejtuesi i Asamblese cakton nje sekretar. Procesverbali i mbledhjes duhet te firmoset nga drejtuesi dhe sekretari i asamblese se aksionareve.

Neni 15

Keshilli mbikqyres

Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 anetare. Mbeshtetur ne ecurine e zbatimit te investimit Asambleja do te vendose per shtimin e numurit te anetareve te keshillit Mbikqyres dhe te perberjes se tij. Koha e ushtrimit te detyres eshte 3 vjet per anetaret e caktuar ne Statut dhe jo me shume se 6 vjet per anetaret e emeruar nga Asambleja.

Ne rast se nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i Drejtorise, mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon sapo ai te kaloje ne funksionin e ri.

Antaret e Keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqjen nga detyra me anen e nje deklarate e cila duhet ti dergohet Krytarit te Keshillit Mbikqyres duke respektuar nje limit kohe prej dy javesh.

Keshilli Mbikqyres ka keto kopetenca:

1. Emeron anetaret e drejtorise dhe Drejtorin e shoqerise.
2. Kontrollon Drejtorine e shoqerise per plotesimin e detyrave te saj.
3. Ka te drejte te mbikqyre ne cdo kohe manaxhimin e shoqerise dhe dokumentacionin e nevojshem.
4. Mund ti propozoje Asamblese ndryshime ne Statut.
5. Miraton rregulloren e brendeshme mbi funksionimin e Drejtorise se shoqerise.
6. Therret ne raport drejtorine, e cila pergatit nje raport qe mbulon aktivitetin e Shoqerise, te pakten çdo tre muaj.

NENI 16

Kryetari dhe Zv. kryetari i Keshillit Mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh midis anetareve te tij nje kryetar dhe nje Zevendes kryetar. Zgjedhja e tyre behet ne mbledhjen e pare. Ne qoftese Kryetari ose zevendesi i tij lirohen nga detyra para mbarimit te afatit, do te kryhet nje zgjedhje tjeter per periudhen e mbetur. Ne pamundesi te ardhjes ne mbledhje te kryetarit dhe zevendesit te tij detyrat do te kryhen nga anetari me i vjeter ne moshe.

Keshilli mbikqyres mund te percaktoje rregulla te brendeshme lidhur me proceduren e punes.

Vendimet e Keshillit mbikqyres firmosen nga Kryetari dhe Zevendes kryetari.

NENI 17

Mledhjet e keshillit Mbikqyres

Mledhjet e keshillit Mbikqyres thirren me shkrim nga Kryetari ose ne mungese te tij nga Zv. Kryetari. Lajmerimi behet 15 dite perpara dates se mbledhjes. Ne raste urgjente lajmerimi mund te behet gojarisht, me telefon telfaks ose telegram. Ne ftese specifikohet rendi i dites.

Antaret e Keshillit Mbikqyres mund te shtrojne ne mbledhje edhe ceshtje te tjera te cilat duhet ti behen te njohura Kryetarit me ane te nje letre te pakten 10 dite para mbledhjes. Te gjitha anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet te informohen per shtesat e rendit te dites.

Mbledhja e Keshillit Mbikqyres rregullisht behet ne seline e shoqerise, por mund te behet edhe ne ndonje vend tjeter qe Kryetari e shikon te arsyeshme.

Keshilli Mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem , ne qoftese jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te Keshillit. Vendimet merren me shumice te thejshte votash. Ne rast votash te barabarta , ajo e Kryetarit eshte percaktuese.

Mbledhja do te drejtohet nga Kryetari dhe ne mungese te tij nga Zevendesi i tij. Kryetari vendos radhen e rendit te dites, llojin dhe radhen e votimit.

Proces verbalet e mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres duhet te pergatiten dhe te neneshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes.

NENI 18

Drejtoria


Shoqeria drejtohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare. Numuri i antareve te drejtorise caktohet nga Asambleja.

Drejtori perfageson shoqerine ne mardhenie me te tretet.

Anetaret e drejtorise mund te zgjidhen si brenda edhe jashte bashkesise se aksionereve. Ne se nje anetar i Keshillit Mbikqyres, emerohet anetar i drejtorise, mandati i tij ne Keshillin Mbikqyres perfundon. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen vetem per shkaqe te perligjura.

Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 2 vjetesh.

Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga Keshilli Mbikqyres.



NENI 19

Kopetencat e Drejtorit

Drejtori ka kopetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e neneshkruara nga drejtori i saj.

Drejtori ka te drejten te autorizojte persona te tjere per te neneshkruar akte ne emer te shoqerise.

Drejtori ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton Keshilli Mbikqyres.

Drejtori pergatit raportin e administrimit te shoqerise dhe ja paraqit Keshillit Mbikqyres

Punon per zbatimin me saktesi te vendimeve te Asamblese se ortakeve, organizimin e punes per realizimin e objektit te shoqerise

Administron pasurine e shoqerise, duke perfshire mjetet financiare dhe kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise.

Perfaqeson shoqerine ne mbrojtjen e interesave te saj ne gjykate apo arbitrazh, ne banka dhe cdo institucion tjeter, nenshkruan kontrata ne emer te shoqerise dhe ndjek zbatimin te tyre

Emeron dhe shkarkon punonjesit dhe nenshkruan kontrata kolektive dhe individuale me ta.

Neni 20

Llogarite vjetore

Viti financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti.

Perjashtimisht viti i pare financiar perfshin kohën nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar deri me 31 dhjetor.

Shoqeria do te mbaje kontabilitetin e saj sipas ligjit ne fuqi.

Rezultati financiar del nga diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem .

Nga fitimi, hiqet 5% dhe kjo mbahet si rezerven legale e domosdoshme.


Kur rezerva legale e domosdoshme arrine 10% te kapitalit, mbajtja e rezervave shtese nuk eshte e detyrueshme. Shperndarja e fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me vendim te Asamblese se aksionereve.

Neni 21

Emerimi i anetareve te pare te keshillit Mbikqyres

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane:

1. HASAN BERKPINAR
2. AYHAN ÇETINER
3. MOİZ BERKMAN



Neni 22

Emerimi i ekspertit kontabel te autorizuar

Ekspert i pare kontabel i autorizuar emerohet Z. LAVDIMIR FUSHA.

Neni 23

Likujdimi

Likujdimi i shoqerise vendoset nga Asambleja e jashtezakonshme e aksionereve
Procesi i likujdimit te shoqersie do te behet ne perputhje me Seksionin e V te Kreut te
VI te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Neni 24


Dispozita te pergjithshme

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, vlejne dispozitat e legjislacionit ne fuqi per
shoqerite tregtare.


AKSIONERET

1. BER-ONER MADENCILIK VE TICARET A.S. Buyukdere Cad. Noramin Is
Merkezi No: 55, Kat: 3, D:304 80670-MASLAK-ISTANBUL-TURKEY, regjistruar
me Nr. 237240-184807, date 13 Janar 1993, si kompani minerare, e perfaqesuar nga


HASAN BERKPINAR



2. AYHAN ÇETINER



3. BERTAN H. BERKPINAR



4. MOİZ BERKMAN



5. SHAHIN ÇELİK

Perkthet
Julia Krosqi



NOTERI